

Datë: 15 Tetor 2020

FTESË PËR OFERTË

TEB SH.A i fton të gjitha palët e interesuara të ofertojnë për blerjen e Automjeteve të sekuestruara.

Automjetet janë të vendosura në parkingun e TEB SH.A-së i cila gjendet në lokacionin "Rruga Agim Ramadani, Nr 15, Prishtinë" (parkingun e TEB SH.A-së, kordinatat Google Maps 42.662386, 21.165546). Automjetet mund të shikohen nga palët e interesuara më datë:16-20 Tetor, 2020, duke filluar nga ora 10:00 – 16:00.

Palët e interesuara mund të ofertojnë duke e shkarkuar listën nga web-faqja "[www.teb-kos.com/Automjete dhe asetet tjera të luajtshme në shitje](http://www.teb-kos.com/Automjete_dhe_asete_tjera_të_luajtshme_në_shitje)", ofertimi duhet të bëhet në mënyrë specifike/individuale për secilin automjet, sipas listës.

Oferta e nënshkruar nga ofertuesi së bashku me kopjen e letërnjoftimit të tij dhe të dhënat tjera të kërkuara në aplikacion, duhet të vëndosen në një pliko të mbyllur të formatit A4 me mbishkrimin "**Ftesë për Ofertë Nr.121020**" dhe të dorëzohën në recepsionin e zyrës qendrore të TEB SH.A-së me adresë; ***Preoc pn. Kilometri i 7-të i magjistrales Prishtinë – Ferizaj*** (kordinatat Google Maps 42.5986582, 21.1302606), jo më vonë se datën **21 Tetor, 2020, ora 16:00.**

Të gjitha ofertat e pranuar me kohë siç është kërkuar më lartë, do të shqyrtohen nga autoriteti përkatës i TEB SH.A-së. **Fituesit do të përcaktohen sipas kriterit >>oferta më çmimin më të lartë<<.** Fituesit do të njoftohen përmes e-mailit/telefonit dhe të njëjtit duhet që brenda 5 ditë pune, pas njoftimit nga TEB-SH.A ti kryejnë pagesat e zotuar në ofertë.

Dorëzimi i automjeteve të shitura do të bëhet vetëm pasi të është nënshkruar kontrata e shitë-blejës dhe pasi që pagesa të jetë konfirmuar në llogarinë e TEB SH.A-së.